AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY

Republika e Kosoves
Republika Kosova - Republic of Kosovo
AGJENCIA PER INFORMIM DHE PRIVATESI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY
ZYRA E ARKIVIT - KANCELARIJA ARHIVA - ARCHIVE OFFICE
Njesia Org. 01 Nr. i Prot. 1046
Org. Jedi. Br. Prot.
Org. Unit Prot. No.
Nr. i Faqeve 04 Data:
Broj Stranica Datum 29 09 2026
No. of Pages Date:

DRENAS

KOMUNA GLLOG
MUNICIPAL GLLOGOC
01 Nr. 400/01-41438
Më 29/09/2026

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

AGJENCISË PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI

dhe

KOMUNËS SË DRENASIT

Ky Memorandum Bashkëpunimi (në tekstin e mëtejmë: "Memorandumi") lidhet ndërmjet Agjencisë për Informim dhe Privatësi me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga **Komisionerja znj. Krenare Sogojeva – Dermaku** dhe Komunës së Drenasit, e përfaqësuar nga **Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci.**

Duke marrë parasysh detyrimin e institucioneve publike për publikim pro aktiv të dokumenteve publike sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike; bazuar në Planin e Veprimit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (2026–2028) përkatësisht Zotimin 3 "*Standardizimi dhe përmirësimi i publikimit pro aktiv të dokumenteve publike dhe monitorimi i platformës së të dhënave të hapura*"; si dhe marrë parasysh rëndësinë e bashkëpunimit institucional për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare, Palët arrijnë marrëveshjen, si në vijim:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është themelimi i një kuadri bashkëpunimi ndërmjet AIP-së dhe Komunës së Drenasit, për zbatimin e detyrimeve ligjore dhe institucionale që ndërlidhen me publikimin pro aktiv të dokumenteve dhe informacioneve publike, në veçanti atyre që lidhen me shërbimet publike që Komuna i ofron qytetarëve.

Ky Memorandum, para se gjithash, synon të kontribuojë në:

- *rritjen e transparencës institucionale;*
- *përmirësimin e qasjes së qytetarëve në informata publike;*
- *standardizimin e publikimit të informatave mbi shërbimet publike;*
- *forcimin e llogaridhënies dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në monitorimin e institucioneve publike.*

Neni 2
Fusha e bashkëpunimit

Ky Memorandum zbatohet në kuadër të një qasjeje të strukturuar dhe të standardizuar për publikimin pro aktiv të dokumenteve, të cilën AIP po e zhvillon në partneritet me institucionet përgjegjëse publike.

Me anë të këtij memorandumi, synohet të ndërtohet një model i unifikuar transparence, i cili më pas do të mund të aplikohet nga Komuna e Drenasit në kuadër të zbatimit të obligimeve përkatëse që derivojnë nga Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Bashkëpunimi ndërmjet palëve do të përfshijë, ndër të tjera:

- *Përzgjedhjen e shërbimeve publike të Komunës që do të jenë pjesë e fazës pilote të publikimit pro aktiv të standardizuar;*
- *Zbatimin e udhëzuesit të standardizuar për publikimin pro aktiv të dokumenteve, të hartuar nga AIP;*
- *Zhvillimin e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë përgjegjës për informim publik dhe komunikim, përmes trajnimeve të ofruara nga AIP;*
- *Caktimin nga ana e Komunës të një personi kontaktues përgjegjës për publikimin dhe përditësimin e informacioneve mbi shërbimet publike;*
- *Monitorimin e vazhdueshëm nga AIP të zbatimit të publikimit pro aktiv nga Komuna, përfshirë përdorimin e platformës së të dhënave të hapura, kur zbatohet;*
- *Shkëmbimin e përvojave praktike, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të modelit të standardizuar;*
- *Krijimin e kushteve që qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe media të bëhen pjesë aktive e ndjekjes dhe monitorimit të zbatimit të politikave dhe aktiviteteve institucionale të Komunës, duke inkurajuar kështu pjesëmarrjen e tyre në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike.*

Neni 3
Zbatimi

Zbatimi i këtij Memorandumi do të realizohet në përputhje me hapat dhe afatet e parapara në Planin e Veprimit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (2026–2028), përkatësisht Zotimin 3 "Standardizimi dhe përmirësimi i publikimit pro aktiv të dokumenteve publike dhe monitorimi i platformës së të dhënave të hapura.

AIP dhe Komuna e Drenasit do të themelojnë një pikë të përbashkët koordinimi për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Memorandumi dhe raportimin periodik mbi progresin e arritur.

Neni 4
Aktivitetet e Palëve

Aktivitetet e AIP-së-:

- *Hartimi, miratimi dhe dërgimi i Udhëzuesit të standardizuar për publikim pro aktiv të dokumenteve publike;*
- *Organizimi i trajnimeve për zyrtarët e Komunës, përgjegjës për informim publik, komunikim dhe raportim;*

- *Ofrimi i asistencës teknike dhe metodologjike gjatë procesit të vlerësimit bazë dhe zbatimit;*
- *Mbështetje Komunës në hartimin e Planit Institucional të Veprimit dhe në vendosjen e proceseve të brendshme të punës;*
- *Monitorimi periodik i zbatimit të obligimeve për publikim pro aktiv nga ana e Komunës dhe përgatitja e raporteve përkatëse;*

Aktivitetet e Komunës së Drenasit:

- *Caktimi i zyrtarit përgjegjës për publikimin dhe përditësimin e informacionit mbi shërbimet e ofruara nga Komuna;*
- *Caktimi i zyrtarit përgjegjës për raportim lidhur me zbatimin e obligimeve të cilat dalin nga Plani i Veprimit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (2026–2028), përkatësisht Zotimin 3 "Standardizimi dhe përmirësimi i publikimit pro aktiv të dokumenteve publike dhe monitorimi i platformës së të dhënave të hapura;*
- *Hartimi dhe miratimi i Planit Institucional të Veprimit për publikimin pro aktiv, duke përcaktuar përgjegjësitë, afatet dhe njësitë organizative përgjegjëse;*
- *Pjesëmarrja e zyrtarëve komunalë në punëtoritë trajnuese të organizuara nga AIP;*
- *Vendosja e proceseve të brendshme të punës për rishikimin dhe përditësimin e rregullt të informacionit të publikuar;*
- *Përgatitja e listës së dokumenteve të cilat do t'i nënshtrohen publikimit pro aktiv;*
- *Bashkëpunimi me AIP gjatë procesit të monitorimit dhe raportimit të obligimeve përkatëse për publikimin pro aktiv të dokumenteve dhe informacioneve publike.*

Neni 5
Obligimet e përgjithshme të palëve

Palët obligohen të bashkëpunojnë me mirëbesim dhe të shkëmbejnë në kohë të gjitha informacionet e nevojshme për zbatimin e këtij Memorandumi, dhe në këtë drejtim të rishikojnë periodikisht progresin, dhe sipas nevojës, të propozojnë masa për përmirësimin e zbatimit.

Palët obligohen të respektojnë obligimet që dalin nga Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, dhe njëkohësisht të sigurojnë që publikimi proaktiv të realizohet në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe interesit publik;

Palët caktojnë nga një person kontaktues për komunikim të vazhdueshëm lidhur me zbatimin e këtij Memorandumi.

Çdo ndryshim i këtij Memorandumi bëhet me marrëveshje të ndërsjellë me shkrim ndërmjet Palëve, në formë të një aneksi.

Neni 6
Monitorimi dhe Raportimi

AIP dhe Komuna do të hartojnë raporte periodike mbi progresin e zbatimit të Memorandumit. Raportet do të bazohen, ndër të tjera, së paku në treguesit për sa i përket numrit të shërbimeve të standardizuara, përditësimit të rregullt të përmbajtjes së informatave, numrit të zyrtarëve të trajnuar, rekomandimeve dhe masave korrigjuese të zbatuara, etj.

Raporti përfundimtar i fazës pilot do të shërbejë si bazë për vlerësimin e modelit dhe për zgjerimin e tij në institucione të tjera publike.

Neni 7
Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave

Palët angazhohen që gjatë zbatimit të këtij Memorandumi të veprojnë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Publikimi pro aktiv i dokumenteve dhe informacioneve në kuadër të zbatimit të këtij Memorandumi do të bëhet duke respektuar përjashtimet dhe kufizimet ligjore që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale, sekretet afariste dhe interesa të tjera të mbrojtura me ligj.

Neni 8
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind nga zbatimi ose interpretimi i këtij Memorandumi zgjidhet me marrëveshje dhe konsultime të ndërsjella ndërmjet Palëve.

Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e ngritjes së saj me shkrim nga njëra Palë, çështja i referohet nivelit më të lartë drejtues të secilës Palë për zgjidhje përfundimtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 9
Kohëzgjatja

Ky Memorandum lidhet për një periudhë prej dy (2) vjetësh nga data e nënshkrimit, dhe mund të vazhdohet me marrëveshje të ndërsjellë me shkrim ndërmjet Palëve.

Secila Palë mund ta ndërpresë këtë Memorandum para skadimit të afatit, me njoftim me shkrim drejtuar Palës tjetër, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para datës së synuar të ndërprerjes.

Ndërprerja e Memorandumit nuk cenon obligimet e ndërmarra deri në atë datë dhe nuk pengon përfundimin e aktiviteteve tashmë të filluara, përveç nëse Palët merren vesh ndryshe.

Neni 10
Dispozitat përfundimtare

Ky Memorandum nuk ka karakter të detyrueshëm financiar dhe nuk krijon obligime buxhetore për Palët, përveç nëse për aktivitete specifike lidhet marrëveshje e veçantë financiare.

Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja Palët dhe hartohet në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën Palë.

Krenare Sogojeva Dermaku

Komisionere e Agjencisë për Informim dhe Privatësi

Ramiz Lladrovci

Kryetar i Komunës së Drenasit